

Prot. 2404/015K (e-k)
Tiranë, më 03 / 04 / 2024

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
z. Ilirjan CELIBASHI

Drejtuesve të Administratës së KQZ

Dy Organeve të tjera Drejtuese

Komisionit Rregullator

Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve

Në vëmendje të: Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Presidentit të Republikës të Shqipërisë

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Kryetarëve të Partive Politike pjesëmarrëse
në Zgjedhjet e Përgjithshme 2021 apo 2023

Institucioneve të Pavarura të përcaktuara në
Kushtetutë apo me Ligj të Veçantë

Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë

Delegacionit të Bashkimit European në Tiranë

Ambasadës Britanike në Tiranë

Ambasadave të Vendeve pjesë e Bashkimit European në Shqipëri

Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të OSBE (OSBE/ODIHR)

Prezencës së OSBE në Tiranë

Zyrës së Këshillit të Europës në Tiranë

Përfaqësive apo Programeve të Qeverive të tjera Partnere të Shqipërisë, mbështetëse të mirëfunksionimit të KQZ-së

Organizatave vendase dhe të huaja, mbështetëse dhe bashkëpunëtore të KQZ-së, me angazhim në çështje zgjedhore

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Lënda: OPINION mbi kontekstin politik në vend, në linjë me Rekomandimet e KRIIK mbi procesin e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe të materialit zgjedhor të përdorur nga komisionet zgjedhore në Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023 dhe Zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023

I Nderuar z. Komisioner!

Të nderuar Drejtues të Administratës së KQZ-së!

Duke marrë shkas nga përcjellja për konsultim e Projekt-Raportit “Mbi gjetjet e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe të materialit zgjedhor të përdorur nga komisionet zgjedhore në Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14.05.2023 dhe për Zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24.09.2023”, apo të ashtuquajturit “proces i Auditit Pas-Zgjedhor”,

në kuadër të gjithë bashkëpunimit me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve lidhur me konsultimin paraprak të projekt-akteve, për të cilin gjejmë rastin t’Ju falënderojmë sërish,

KRIIK Ju paraqet më poshtë disa komente dhe rekomandime në lidhje me Projekt-Raportin¹, ndërkohë që rithekson, me anë të këtij Dokumenti,

edhe domosdoshmërinë që **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të vazhdojë të çojë përpara dhe zbatojë pa ekuivok e në mënyrë të plotë ligjin në aplikimin e masave në zbatim të gjetjeve të këtij procesi.**

Ky Dokument po ju paraqitet në një format të ndryshëm nga dhjetëra Dokumentet (rekomandime, sugjerime, opinione, etj.) të komunikuar përgjatë tre viteve të shkuara në mënyrë intensive e mjaft frytdhënëse midis KRIIK dhe Institucionit të KQZ-së, komunikim i cili ka qenë i drejtpërdrejtë midis nesh, por që në çdo rast, vlen të theksohet se ka siguruar transparencë të plotë, duke u publikuar në të njëjtën kohë në faqen e internetit të KRIIK, ku mund të shkarkohen prej kujt do, shtu edhe citimin e tyre si pjesë e Raporteve apo Qëndrimeve Publike, të publikuara gjerësisht në media e në opinionin publik.

Në parantezë, KRIIK ri-sjell në vëmendjen tuaj të nderuar Drejtues të Institucionit të KQZ, dhe për shkak të kontekstit politik e zhvillimeve institucionale të fundit, në kushtet e një mungese totale të transparencës,

edhe në vëmendjen e Gjithësecilit prej Jush, **të Nderuar Përfaqësues të Institucioneve dhe organizatave partnere** të cilëve iu dërgohet ky Dokument,

shqetësimin madhor e të ri-përsëritur të KRIIK, nisur nga Dështimi i Reformës Zgjedhore prej Partive Politike në Kuvend, me shumë gjasa, **të një dakordësie politike të momentit të fundit, të rakorduar, me synim stopimin e ligjzbatimit të ndjekur, të mirëfunksionimit e të rekordeve tejet pozitive të arritura deri më tani prej Institucionit të KQZ-së, si një proces shumë domethënës pozitiv e funksional në ndërtimin e procesit shtetformues në Shqipëri**, si dhe të përpjekjeve për të siguruar paprekshmërinë e votës së lirë të qytetarëve, integritetit të zgjedhjeve e të së sotmes demokratike të vendit.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

¹ Duke qenë se jemi njohur vetëm me përmbajtjen e Projekt-Raportit, i cili nuk shoqërohet nga një projekt-vendim, propozimet kufizohen në tekstin e Projekt-Raportit, megjithëse në gjykimin e KRIIK përcjellja për konsultim paraprak do të ishte më e plotë nëse në të do të ishte bashkëlidhur edhe projekt-vendimi.

Për më tepër, që, për herë të parë, pas dështimit të Reformës Zgjedhore, **në mënyrë të paprecedentë, në mes të një kompromisi të arritur politik për të cilin nuk ka asnjë lloj transparence**, u mor vendimi për ngritjen e një Grupi Pune apo Nën/komisioni pranë Komisionit të Ligjeve, i cili ndër të tjera, *de-facto*, do të zëvendësojë Komisionin e Posaçëm Parlamentar, **pa asnjë deklaram publik institucional dhe pa detyrimet që Kuvendi i vendos Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore dhe të raportimit, sikurse kuadri rregullator ligjor parashikon.**

Madje, **ngritja me urgjencë sot e një Komisioni tjetër të ri të Posaçëm Parlamentar**, i miratuar sot në Konferencën e Kryetarëve të Kuvendit **me nxitim dhe vetëm me votat e maxhorancës socialiste**, dhe që pritet të miratohet në seancën e nesërme të Kuvendit, **me afat prej së paku një vit, pra aq kohe sa ka mbetur deri në përfundim të afatit të Legjislaturës aktuale përpara zgjedhjeve parlamentare të Prill 2025**, me iniciativë të po të njëjtëve deputetë, **ekskluzivisht prej maxhorancës, të cilët dështuan me Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore**, duke e lënë mandatin e tij të përfundojë pa asnjë produkt ligjor të miratuar, **një propozim i cili mbetet i paqartë dhe në mungesë totale transparence**, ngrenë pikëpyetje të reja, duke rritur akoma më shumë **pasigurinë e funksionimit të demokracisë sot dhe të rrezikut që i kanoset lirisë së shprehjes, e lirive e të drejtave kushtetuese të qytetarëve dhe të aktorëve e faktorëve të shoqërisë e vendit.**

Argumentimi në emër të një rreziku të jashtëm madhor, sikurse paraqitet në kërkesën e deputetëve iniciues, paraqitet në vetëm dy paragrafë shumë të përgjithshëm për legjitimitimin e tij, ndërsa **pjesa më e madhe e përmbajtjes së Kërkesës duket se është përqendruar dhe dedikuar sferave të kontrollit të Komisionit ndaj një sfere tejet të gjerë të aktorëve vendas**, të cilët do të kenë detyrimin t'i përgjigjen atij në mënyrë të menjëhershme përgjatë vitit në vazhdim që na çon në zgjedhjet e 2025-ës.

Ndërkohë që për një natyrë të tillë rreziku sigurie, **Komisioni Ad-Hoc i njeh të drejtën vetes për të ftuar eksperte sigurie nga partnerët kryesorë si BE, NATO e SHBA, gjithmonë nëse do ta gjykojë të nevojshme në të ardhmen**, duket se **nuk është gjykuar e arsyeshme të parashikohet në Kërkesën e bërë, prania e përhershme e kësaj ekspertize e konsulence nga Partneret Strategjike të Vendit, si pjesë thelbësore dhe e pandarë në tërë veprimtarinë e parashikuar të këtij Komisioni.**

Këto zhvillime **ngrenë pikëpyetje të forta dhe thellojnë paqartësinë në lidhje me kompromiset politike të momentit të fundit**, të cilat mund të çojnë në hapa pas, në kthim të situatave dhe krizave politike ciklike të disa viteve më parë, të cilat bëjnë që të prevalojnë interesat e ngushta politike apo të natyrave të tjera korruptive, **duke zhbërë aspiratat, angazhimet politike të ndërmarra dhe vetë Institucionet**, sikurse ka ndodhur me Institucionin e KQZ-së gjatë periudhës 2012 – 2020. Përvoja negative këto, të cilat **në asnjë rast nuk duhet më të konsiderohen si kompromise politike apo të shërbejnë si mënyra të reja inxhinierimi prej politikës me synim zhbërjen apo stopimin e ligjzbatimit prej Institucionit të sotëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.**

Një rikthim i përvojave të tilla negative, nuk është gjë tjetër veçse shënim i hapave pas në procesin e ligjzbatimit të barabartë të nisur ndaj çdo shkelësi të ligjit, duke ndikuar drejtpërdrejtë më pas në krijimin e klimës mosbesuese dhe zhbërëse të efekteve pozitive e besimit që po jep nga ana tjetër procesi i Reformës në Drejtësi, veçanërisht nëpërmjet veprimtarisë së SPAK e GJKKO, **duke shënuar një situatë të paprecedentë e të paimagjinueshme për vendin.**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Siç e tha edhe Sekretari i Shtetit i SHBA, Blinken, rreth dy javë më parë në Austri, rreziku dhe ajo **çka nuk duhet të lejohet është pikërisht kthimi në të shkuarën**, duke ripërsëritur të njëjtat gabime dhe **shënjuar hapa pas në konsolidimin e shtetit ligjor dhe demokracisë**.²

KRIIK rithekson dhe rikthen në vëmendjen e Gjithsecilit prej Jush, të Nderuar Përfaqësues të Institucioneve dhe organizatave partnere të cilëve iu dërgohet ky Dokument, se Procesi i Auditit Pas-Zgjedhor apo **këqyrja e mëpasshme e fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore vlerësohet si një proces shumë domethënës** në funksion të ligjzbatimit, i cili është pranuar dhe dakordësuar nga forcat politike për t'u bërë **pjesë e mekanizmave garantues të integritetit të zgjedhjeve si rrjedhojë e Marrëveshjes Politike të 5 qershorit 2020**, marrëveshje e cila i dha fund krizës së tejzgjatur politike dhe institucionale 2017-2020 dhe ripërfshiu opozitën në jetën institucionale.

Ishte kjo krizë politike dhe institucionale e cila **nxori në pah domosdoshmërinë e kalimit** nga modeli i funksionimit vetëm nën parimin e balancës politike, **në atë të referimit në verdiktin e institucioneve** e të respektimit të procesit ligjzbatues të ndjekur prej tyre.

Si Reforma në Drejtësi dhe ajo Zgjedhore e 2020-ës, në veçanti ri-organizimi i Institucionit të KQZ-së, **shënuan hapa konkretë e decizivë në përpjekjen shtetformuese të vendit si dhe vendosën një standard të ri politik e institucional**, ku ligjzbatimi është i plotë dhe ku integriteti i institucioneve, së pari ai atyre ligjzbatuese dhe të pavarura, duhet të jetë i siguruar.

Ky standard **parashtron nevojën për një mentalitet dhe sjellje të re, veçanërisht të klasës politike**, e cila duhet të ketë **në themel të saj moralitetin, legjitimitetin, ligjshmërinë dhe integritet të plotë** duke u distancuar në mënyrë të menjëhershme, të vërtetë dhe publikisht prej kujtdo që shkel ligjin apo abuzon në çfarëdolloj forme me të apo me përgjegjësitë publike të marra përsipër.

Një qasje e tillë është e domosdoshme **të tregohet së pari prej të gjitha partive politike ndaj të gjithë përfaqësuesve të vet**, qofshin këta funksionarë, anëtarë, aktivistë apo kandidatë, që ndodhen në konflikt apo akuzë prej ligjit në mënyrë që të sigurojnë hapësirën e nevojshme, objektive e të pa ndikuar, të funksionimit të institucioneve dhe të zbatimit në mënyrë të plotë dhe të paekuivok të ligjit.

Në procesin e forcimit të shtetit ligjor dhe institucioneve, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka një rol kyç**.

KQZ-ja është një Institucion i Pavarur i krijuar me ligj, **por me një rëndësi dhe natyrë të veçantë, i cili nevojitet të konsiderohet dhe trajtohet si i tillë**.

KQZ-së i duhet jo vetëm të organizojë e administrojë tërë procesin zgjedhor, duke menaxhuar më shumë se 40.000 administratorë zgjedhorë apo staf tjetër mbështetës, por është i ngarkuar edhe me detyra të tjera shumë të rëndësishme si procesi i dekriminalizimit, ushtrimi i rolit si mbikëqyrës dhe kontrollues i financimit të partive politike e fushatave zgjedhore, apo edhe parandalimi i përdorimit të burimeve shtetërore për avantazh elektoral, duke qenë, në thelb, **garantues i integritetit të procesit zgjedhor dhe rezultatit të zgjedhjeve**.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

² **Fjala e Sekretarit të Shtetit të SHBA**, Anthony J. Blinken në Konferencën e përbashkët për Shtyp me Ministrin e Jashtëm të Austrisë në Vjenë, 15 mars 2024: "Dhe një gjë që nuk na nevojitet, që Evropa nuk ka nevojë, dhe veçanërisht njerëzit e Ballkanit Perëndimor nuk kanë nevojë, është një moment i kthimit në të shkuarë, ku e gjejmë veten në vitet 1990. Dhe falë angazhimit të Austrisë, lidershit të Austrisë, ne po ecim me vendosmëri në një drejtim tjetër, një drejtim pozitiv, një drejtim në të cilin Ballkani Perëndimor është sinqerisht i integruar me Evropën. Ne ndajmë qëllimin e një rajoni demokratik, të begatë, paqësor të integruar me pjesën tjetër të Evropës."

Pikërisht për shkak të detyrave që mbart nga ligji dhe rolit tejet domethënës që luan, **Institucioni i KQZ përballet me sfida madhore**, me të cilat përballet vetë shteti, demokracia dhe shoqëria shqiptare, **ai i zbatimit të ligjit në mënyrë të barabartë, edhe në përballje me pushtetin politik apo të personave të lidhur me të, sikurse Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon dhe përcakton qartë.**

KRIIK ka advokuar me forcë dhe në vijimësi, prej më shumë se një dekadë, **pikërisht për forcimin e Institucionit të KQZ-së, rritjen e kapaciteteve dhe dhënien e mbështetjes në nivel politik në radhë të parë, si dhe të burimeve të tjera të nevojshme për t'u përballur me këtë sfidë madhore të pandëshkueshmërisë dhe moszbatimit të ligjit**, veçanërisht në raport me Administratën e KQZ-së, në të gjitha nivelet, për ta shpëtuar nga ndikimet e leximet negative të ligjit e mbrojtur atë nga presioni i drejtpërdrejtë e tejet i konsiderueshëm prej politikës. Sfidë të cilat kishin në atë kohë të kuptuar të ngushtë apo “të qëllim të qartazi politik deri diku” edhe në radhët e Administratës përpos anëtarësisë së Trupës drejtuese të KQZ-së, **i kuptuar apo qasje minore që tenton edhe aktualisht sot, aty-këtu, të ngrejë krye, zërë vend apo pengojë proceset pozitive ligjzbatuese administrative të brendshme institucionale të nisura e që nevojiten të përmirësohen e të çohen më tej.**

Ky advokim është kryer në vazhdimësi në mënyrë zyrtare, në takime publike apo jopublike me nivelet më të larta drejtuese të Institucioneve dhe partive politike, sikurse edhe me përfaqësuesit më të lartë të Trupit Diplomatik të Vendeve Partnere mike të Shqipërisë, të cilët kanë ndihmuar dhe ndihmojnë në vazhdimësi për forcimin e demokracisë në vend.

Në ndërkohë, KRIIK ka mbështetur në vijimësi dhe fort veprimtarinë pozitive të Institucionit të KQZ-së e veçanërisht nismat e transparencës dhe bashkëpunimit të hapur të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me të gjithë aktorët, vendas e të huaj, që mund të kontribuojnë në cilësinë e zhvillimit të procesit zgjedhor në vend e forcimin e mëtejshëm të rolit dhe Institucionit të KQZ-se.

Një angazhim pro-aktiv KRIIK ka ofruar në vijimësi në takimet periodike të zhvilluara me aktorë që kanë interes dhe ekspertizë në çështjet zgjedhore, vendas apo të huaj, që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka organizuar periodikisht gjatë tre viteve të fundit.

KRIIK, sikurse edhe më parë, ka ngritur në vijimësi shqetësimin për mungesën dhe nevojën e ndërveprimit e kontributit që duhet të japin veçanërisht këta aktorë me interes apo që kanë edhe ekspertizë e kapacitete, dhe që mund të ndihmojnë KQZ-në në këtë përballje me presionin politik për rritjen e efektivitetit të punës dhe zbatimin e ligjit prej saj.

Ndërsa theksohet këtu pranimi katërcipërisht i vullnetit të lirë të secilit aktor apo organizatë të shoqërisë civile në mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së tyre, shprehen edhe rezerva për mungesën e ndërveprimit megjithë dhënien e dakordësisë në parim paraprakisht, apo për mos reagimin ndaj një sërë problematikash realisht serioze dhe përmbajtësore të prezantuara, të cilat shkojnë përtej ditës së zgjedhjeve apo përtej një iniciative specifike. Por që në thelb lidhen me misionin dhe angazhimin që secili prej këtyre aktorëve ka marrë përsipër lirisht, bazuar në të drejtat e privilegjet që Kushtetuta dhe kuadri ligjor iu njeh aktorëve dhe organizatave të shoqërisë civile në skenën publike, në dobi të së mirës publike, interesit qytetar e të vendit.

KRIIK, duke marrë shkas nga hartimi i këtij Dokumenti dhe nga aktorët që vihen në dijeni të përmbajtjes së tij, rithekson dhe ri-sjell dhe njëherë në vëmendje domosdoshmërinë për mbështetjen e plotë të Institucionit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në punën e vet shumë pozitive dhe arritjet e deritanishme, pavarësisht problematikave me të cilat duhet të vazhdojë përballet e përmirësojë në vijim. Veçanërisht vlen të mbështetet transformimi i plotë i bërë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Administrata në rezultatet e arritura në përmbushje të ligjzbatimit dhe detyrave të ngarkuara nga ligji, ndërkohë që theksohet edhe nevoja e

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

monitorimit të plotë, nxitjes dhe mbështetjes me kapacitete dhe burime veçanërisht të administratës, por edhe të mbështetjes në radhë të parë politike që duhet të vijë fort nga të gjithë aktorët, si vendas - qytetarë, institucionalë e politikë - edhe ndërkombëtarë, si një **Institucion që duhet të shërbejë si model i ligjzbatimit dhe integritetit**, pasi është dhe mbetet në thelb garantuesi i procesit që përbën gurin e themelit të një shoqërie demokratike.

Bazuar në sa më sipër, është e domosdoshme që KQZ të shqyrtojë me vendosmëri dhe transparencë të plotë të gjitha gjetjet e procesit të këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe materialit zgjedhor, duke i mëshuar realizimit të qëllimit të procesit, ruajtur standardin e vendosur në proceset e mëparshme zgjedhore, madje përmirësuar atë në vazhdimësi, siç e përcakton kuadri ligjor, pa amnistuar askënd e pa relativizuar shkeljet e konstatuara.³

KQZ-ja duhet të shqyrtojë e vlerësojë me objektivitet çdo parregullsi të evidentuar gjatë auditimit të materialeve zgjedhore duke marrë masa administrative e bërë kallëzim penal pa hezitim ndaj të gjithë shkelësve, pavarësisht përkatësisë politike apo llojit të shkeljes, sipas parashikimeve të ligjit.

Zemërgjerësia e treguar prej KQZ-së në proceset e mëparshme të auditimeve të kryera, në emër të mungesës së informimit, edukimit apo edhe të rrisë së mekanizmit, s' duhet të ketë më vend në auditimin e kryer për Zgjedhjet Vendore të 14 majit 2023.

Tashmë parashikimet ligjore nuk përbëjnë më risi dhe tërë parti të politike dhe komisionerët zgjedhorë janë në dijeni të tyre.

Çdo veprim i kryer prej tyre, në dijeni ose jo të subjektit politik që i ka propozuar, është një veprim i kryer me përgjegjshmëri të plotë. Për rrjedhojë, çdo shkelje e kryer me veprim apo mosveprim nuk është gjë tjetër veçse një sfidë e hapur ndaj ligjit, duke relativizuar parashikimin ligjor dhe zhbërë efikasitetin e mekanizmit ligjor garantues të ndërtuar.

Nga ana tjetër, **procesi i Auditimit Pas-Zgjedhor dhe ndërmarrja e sanksioneve bazuar në gjetjet e tij, është sa një detyrë e KQZ-së, aq edhe një proces i cili duhet të mbështet hapur dhe publikisht prej tërë partive politike dhe aktorëve vendorë, ndërkohë që ky nuk duket të jetë rasti.**

Ndërsa gjerësisht dhe vazhdimisht shprehet shqetësimi dhe nevoja për sigurimin e integritetit të zgjedhjeve, **konstatohet me shqetësim se ndaj procesit të Auditimit Pas-Zgjedhor ka patur një indiferencë totale nga tërë aktorët, politikë e jopolitikë**, jo vetëm duke mos e vëzhguar apo ndjekur atë, por edhe duke mos treguar asnjë interes për gjetjet e dala në përfundim të tij.

Në gjykimin e KRIIK, **kjo indiferencë përbën një tregues tejet shqetësues, i cili evidenton mungesën e interesit real, veçanërisht të partive politike**, për cilësinë e zhvillimit dhe të administrimit të procesit zgjedhor, duke u fokusuar në mënyrë të kufizuar vetëm në rezultatin zgjedhor apo edhe në shqetësimet e evidentuara në periudhën përpara shpalljes së tij.

Mungesa e reagimeve apo komenteve nga organizata të tjera me peshë të shoqërisë civile, që kanë ekspertizë apo edhe aktivitet periodik e të pranishëm në opinionin e gjerë publik mbi çështje të zgjedhjeve apo integritetit zgjedhor, kanë bërë që gjithë ky proces thelbësor për

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

³ Rasti i mos sanksionimit të anëtarëve të komisioneve zgjedhore në Pukë e Mallakastër, të cilët u provuan qartazi gjatë procesit ankimor se kishin manipuluar me ndërgjegje rezultatet e votimit³, nuk duhet të shërbejë si precedent për të mos vepruar apo toleruar shkeljet. Shih për më shumë: KRIIK, **QENDRIM PUBLIK** "Qasja proaktive e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në evidentimin dhe denoncimin e krimit zgjedhor, thelbësor për sigurimin e integritetit të zgjedhjeve dhe të ligjzbatimit në vend", datë 02.06.2023.

integritetin e zgjedhjeve dhe gjetjeve të tij, që duhet të çojë veçse në ligjzbatim të plotë e të pa ekuivok, të mbetet kryesisht veç “domain i politikës”. Për rrjedhojë, duke lënë shtigje të hapura për relativizim të problematikës, të vërtetësisë apo qëndrueshmërisë së gjetjeve, apo edhe të relativizimit të zbatimit me forcë të ligjit në rastet e neglizhencës apo lodhjes së komisionerëve, etj., që çon në fakt në relativizimin e zbatimit ose jo të ligjit, sipas opinioneve dhe peshës që politika orkestron.

Tepër e mirëpritur dhe e vlerësuar këtu, lidhur me këtë temë e në këtë situatë aktuale politike, do të ishte çdo koment apo mbështetje publike, në nivel politik, ndaj punës dhe veprimtarisë së KQZ-së në këtë drejtim dhe aktivitetit advokues të organizatave të shoqërisë civile, prej partnerëve të tjerë ndërkombëtarë të cilët kanë ndikuar thelbësisht në përmirësimin e procesit zgjedhor në Shqipëri. Veçanërisht i dy Zyrave Përfaqësuese në Tiranë i dy aktorëve kryesorë në këtë drejtim, Prezenca e OSBE-së dhe Zyra e Këshillit të Europës, në linjë edhe me qëndrimin e kahershëm të tyre për një administrim jo-politik dhe katërcipërisht konform ligjit të procesit të administrimit të zgjedhjeve. **Organizma prestigjioze ndërkombëtare këto, thelbësorë për zhvillimin e demokracisë në Europë e më gjerë, dhe me një kontribut të çmuar prej rreth tri dekadash në ndërtimin e demokracisë dhe orientimit përfundimtar të Vendit tonë drejt përqaftimit të standardeve dhe vlerave më të mira euro-atlantike demokratike, që janë e mbeten në thelb të krijimit e fuqisë së tyre, parime e vlera që duket se janë lënë disi mënjanë, pa u nxitur e promovuar fort prej Zyrave të tyre Lokale në Tiranë në sfidat me të cilat qytetarët, aktivistët dhe aktoret e shoqërisë civile në vend po përballen me rrezikun ndaj këtyre vlerave dhe pasigurisë së tyre të sot në vend.**

KRIIK, si një aktor i cili ndjek në mënyrë të pandërprerë prej më shumë se një dekade tërë zhvillimet politiko-institucionale me efekt integritetin e zgjedhjeve, ka theksuar dhe vijon të sjellë në vëmendje se **Integriteti i Zgjedhjeve**, terminologji kaq shumë e përdorur sot në media dhe opinionin e gjerë publik, është i lidhur ngushtësisht me sigurimin e integritetit të tërë proceseve përbërëse të tij, përfshirë integritetin e kontributeve të të gjithë institucioneve që kanë rol në proces, integritetin e ofertave elektorale - përfshirë integritetin e kandidatëve e të partive politike, integritetin e vendimmarrjeve dhe funksionimit të vetë Institucionit të KQZ-së, etj.

Projekt-Raporti i përcjellë për konsultim nga KQZ në datën 11 mars 2024, bazohet në procesin e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe materialit zgjedhor, kryer nga KQZ në datat 6-24 nëntor 2023, proces të cilin KRIIK e ka monitoruar nga afër që prej hartimit dhe miratimit të vendimit lidhur me kryerjen e verifikimit pas zgjedhor, për të cilin KRIIK ka depozituar rekomandimet⁴ përkatëse, dhe deri tek kryerja e gjithë procesit faktik të rinumërimit dhe ri vlerësimit prej administratës së KQZ.

KRIIK vlerëson punën e bërë nga Administrata e KQZ-së në hartimin e Raportit të Auditimit Pas-Zgjedhor, por evidenton se sërish **mungon adresimi me një qasje të plotë pro-aktive të KQZ-së në zhvillim të përgjegjësive, rolit dhe kompetencave të cilat i janë dhënë nga ligji.**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

⁴ KRIIK - **REKOMANDIME** – Lidhur me projekt-vendimin "Për përcaktimin e procedurave të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore, për zgjedhjet e organeve të vetëqeverisjes vendore", Nr. 2310/56 K (e-k) Prot. datë 19/10/2023.

Vlen të rikujtojmë se, sipas Kodit Zgjedhor⁵, “këqyrja e mëpasshme e fletëve të votimit dhe e materialit zgjedhor bëhet për të verifikuar rregullsinë dhe saktësinë e veprimtarisë së administratës zgjedhore përgjatë administrimit të procesit dhe vlerësimit e numërimit të votave.”

Duke qenë se këqyrja bëhet vetëm pasi është shpallur rezultati përfundimtar i zgjedhjeve, ka përfunduar procesi i ankimimit dhe zgjedhjet kanë përfunduar, pra gjetjet nuk kanë ndikim në rezultatin përfundimtar, qëllimi i procesit është nxitja e përgjegjshmërisë së administratorëve të zgjedhjeve, në nivelin e dytë dhe të tretë dhe i numëruesve të votave, si dhe eliminimi i kulturës së pandëshkueshmërisë ndaj çdo shkelësi të ligjit, pjesë e administratës së zgjedhjeve, pavarësisht përkatësisë partiake apo lidhjeve politike që mund të ketë.

Ligji përcakton qartë se, **nëse nga zhvillimi i këtij procesi rezultojnë parregullsi ose pasaktësi, që bëjnë me faj zyrtarët zgjedhorë përkatës, KQZ-ja është e detyruar të nisë procedimin disiplinor dhe të bëjë kallëzimin penal për zyrtarët përgjegjës.**⁶

Projekt-Raporti i dërguar nga KQZ me rezultatet e Auditimit Pas-Zgjedhor **ngre një panoramë sërish tepër shqetësuese në lidhje me profesionalizmin e administratës zgjedhore**, në rastin më të mirë, apo tentativave për manipulimin e rezultatit, në rastin më të keq.

Raporti fokusohet në një masë të konsiderueshme në përmirësimet e vërejtura, në krahasim me proceset e mëparshme zgjedhore për të cilat është kryer, veçanërisht lidhur me procesin për Zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021.

Referuar Projekt-Raportit, përmirësimet janë të dukshme⁷, por nuk shpjegohet në mënyrë shteruese se cila është metodologjia e përdorur për të mbërritur në një vlerësim sasior të performancës totale.

Konkretisht, ndërsa në Raport vlerësohet se “Në përgjithësi, nga QV-të e këqyrura rezultojnë se administrata zgjedhore ka përmbushur detyrat e saj në nivelin mesatar 88% nga totali i kërkesave themelore ligjore dhe nënligjore...”⁸, nuk shpjegohet se çfarë metodologjie është përdorur për të arritur në këtë vlerësim numerik, cilat janë kriteret e përdorura, dhe nëse për detyra të ndryshme të administratës, të cilat mund të kenë më shumë a më pak ndikim në integritetin e procesit, është përcaktuar peshë e ndryshme në përlllogaritjen e indikatorit final.

Në mungesë të qartësisë në lidhje me mënyrën se si ky indikator është ndërtuar dhe përlllogaritur, ai nuk bën transparencë reale në lidhje me cilësinë e procesit, por mbetet një vlerësim në dukje arbitrar.

Një problematikë e vërejtur në gjetjet e paraqitura në Raport, **janë raste kur gjetje me potencial të lartë për të dëmtuar integritetin e zgjedhjeve, kalohen duke u cituar shkurt në mënyrë numerike, pa dhënë shpjegime të detajuara, pa u thelluar në arsyet e shkeljes, apo pasojat që shkelja mund të ketë patur.**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

⁵ Neni 167/1, Pika 1 e Kodit Zgjedhor.

⁶ Neni 167/2, pika 8 e Kodit Zgjedhor “Në rast se nga këqyrja e fletëve të votimit ose e materialit zgjedhor konstatohen parregullsi ose pasaktësi, që bëjnë me faj zyrtarët zgjedhorë përkatës, KQZ-ja është e detyruar të nisë procedimin disiplinor dhe të bëjë kallëzimin penal për zyrtarët përgjegjës”.

⁷ Referuar Seksionit 1 “Të dhëna për vendimmarrjet e KQV-ve dhe pasqyrimi i tyre në dokumentacionin e punës”, faqe 5 dhe 6.

⁸ Faqe 5 e Projekt Raportit.

Një shembull i dukshëm është numri i lartë (16%) i qendrave të votimit në të cilat nuk është administruar raporti i hapjes së votimit nga PEI.⁹

Vlen të theksohet këtu se kur flitet për 16% të qendrave të votimit, në praktikë kjo do të thotë se në gjithë vendin nuk është administruar Raporti nga PEI për rreth 834 qendra votimi në rang vendi. Kjo pasi kampionimi i kryer nga KQZ-ja është rastësor dhe, si rrjedhim, gjetjet nga kutitë e hapura mund të përgjithësohen për gjithë qendrat e votimit të hapura gjatë Auditit Pas-Zgjedhor (5.213 të tilla sipas Projekt-Raportit). Kjo logjikë do të përdoret në vijimësi për të gjitha gjetjet.

Ndërkohë, në raport citohen të tjera problematika me PEI, si p.sh. fakti se në 11% (rreth 573) të QV-ve procesi i identifikimit të zgjedhësve ka nisur manualisht dhe vetëm më pas është kaluar në identifikimin me PEI, apo anasjelltas (pa përcaktuar se sa prej rasteve është secila nga këto dy kategori).¹⁰

Gjithashtu se në 2.2% të QV-ve (12 nga ato të audituara, pra rreth 114 në gjithë vendin) e gjithë procedura është kryer manualisht.¹¹

Megjithatë, Raporti nuk shpjegon se në çfarë mase nuk është administruar Raporti i Hapjes së PEI për ndonjë nga arsyet e mësipërme, apo cilat janë arsyet specifike për këtë mungesë.

Kujtojmë se mos administrimi i Raportit të Hapjes nga PEI është një problematikë thelbësore, pasi raporti i hapjes nga PEI garanton se pajisja është me zero rekorde në momentin e nisjes së votimit.

Përpos sa më sipër, nuk është e qartë nëse ka kryer KQZ-ja ndonjë përqasje apo kryqëzim të të dhënave të dala nga auditimi i PEI me ato të dala nga Auditimi Pas-Zgjedhor, në funksion të nxjerrjes së problematikave eventuale, me qëllim marrjen e masave për mos përsëritjen e tyre në proceset e ardhshme zgjedhore.

Një tjetër problematikë që vlen të theksohet është se **Projekt-Raporti nuk tenton asnjë analizë të arsyeve pse KQV-të kanë dështuar** të plotësojnë në përputhje me kuadrin ligjor disa detyra dhe jo disa të tjera, pavarësisht se ato mund të jenë të përsëritura nga Zgjedhjet e vitit 2021.

Veçanërisht shqetësuese mbetet praktika e mosplotësimit të Librit të Protokollit të Mbledhjeve nga KQV-të, apo akoma më keq rastet kur Libri i Protokollit mungon totalisht. Në 8.93% (rreth 645) të qendrave të votimit, sipas rezultateve të paraqitura në Raport nuk është plotësuar LPM.

Gjithashtu, në linjë me sa më sipër, **Projekt-Raporti nuk përmban rekomandime në lidhje me adresimin e problematikave të vërejtura.**

KRIIK rekomandon me forcë që në versionin final të Raportit këto rekomandime jo vetëm të përfshihen, **por të jenë një nga pjesët më të rëndësishme të tij dhe që rekomandimet të jenë konkrete dhe të detajuara**, duke marrë në konsideratë problematikat, dhe jo të përgjithshme siç ka qenë rasti i Raportit të Auditit Pas-Zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

⁹ Faqe 7 e Projekt Raportit.

¹⁰ Po aty.

¹¹ Po aty.

Përtej administrimit të procesit, elementi më i rëndësishëm i procesit zgjedhor që identifikohet nëpërmjet Auditit Pas-Zgjedhor është saktësia e numërimit nga grupet e numërimit të votave, pasi identifikon tentativën më të drejtpërdrejtë potenciale për shtrembërim të rezultatit të zgjedhjeve.

KRIIK vlerëson faktin që KQZ-ja ka tentuar të kontaktojë me të gjithë anëtarët e grupeve të numërimit të votave për të cilët janë konstatuar shkelje, **duke e konsideruar një hap pozitiv përpara dhe një standard të përmirësuar.**

Megjithatë, vërehet se **një numër numëruesish nuk i kanë kthyer përgjigje KQZ-së** ndaj kërkesave për sqarime/argumente shtesë në lidhje me pasaktësitë e vërejtura.

Raporti nuk sqaron nëse ndaj këtyre individëve specifikisht do të propozohen masa administrative për injorimin e një kërkesë nga ana e KQZ-së, në sfidim të hapur të autoritetit të një Institucioni Shtetëror, e që në rastin e KQZ-së ka parashikime të posaçme ligjore.

Në gjykimin e KRIIK, **duhet të ndërmerren pa asnjë hezitim edhe masat e tjera të paparashikuara nga kuadri ligjor**, masa administrative, mos angazhimi tyre si komisionerë në të tjera raunde zgjedhore, apo edhe referim për ndjekje penale aty ku është rasti.

KRIIK vëren me shqetësim se **KQZ-ja vijon praktikën e konsiderimit të gabimit deri në 20 vota** si gabim njerëzor,¹² një praktikë e nisur në vitin 2021, por pa shpjeguar në asnjë rast logjikën se si është arritur në këtë numër arbitrar.¹³

Faktorët e përmendur në raport si faktorë që mund të shpien në gabim njerëzor¹⁴, përveçse jo të plotë, nuk përbëjnë argument për numrin 20 si limit për gabimin njerëzor, por vetëm për faktin se gabim njerëzor pritet të ketë, pra numri 20 mbetet i paargumentuar / arbitrar.

KRIIK, sikurse e ka argumentuar dhe në Qëndrimin Publik të datës 14 dhjetor 2023¹⁵, Ju fton të konsideroni se “devijimi i një vote të vetme nga njëri subjekt tek një tjetër përbën prodhim të një rezultati zgjedhor të falsifikuar, i cili **përmban në vetvete dy manipulime të kryera prej komisionerëve përkatës.** Një që i faturohet pakësimit të rezultatit të subjektit zgjedhor nga hiqet vota dhe një që i faturohet shtimit të rezultatit të subjektit zgjedhor ku shtohet kjo votë” dhe vlerëson se në çdo rast, pavarësisht numrit të votave të numëruara gabim, këta persona duhet të referohen në Prokurori, në përmbushje të detyrimit ligjor.

Së fundmi, vlen të theksohet edhe **dështimi për t’i dhënë vëmendjen e duhur në Raport fenomenit të votave të pavlefshme pasi në fletët e votimit mungojnë vulat e KQV-së.**

Nga këqyrja e fletëve të votimit, 3.4% (rreth 1.400) e totalit të votave të pavlefshme ishin të tilla si pasojë e mungesës së këtyre vulave.

¹² Faqe 14 e Raportit.

¹³ Edhe nëse, në parim, do të pranohej logjika e gabimit njerëzor, masa e gabimit do të ishte e ndryshme në varësi të shumë faktorëve, të tillë si: numri i votave që dikush numëron, niveli i lodhjes së personit që numëron, niveli i distraksioneve në mjedisin përreth, të tilla si ndërhyrjet nga vëzhguesit, etj. Të gjithë këta faktorë e shumë të tjerë të papërmendur këtu mund të ndikojnë në faktorin “gabim njerëzor”, por që janë injoruar totalisht duke konkluduar në një numër totalisht arbitrar.

¹⁴ Po aty: “...standardeve teknike, kushteve të punës, volumit të fletëve të votimit, natyrës së procesit dhe afateve kohore që dikton Kodi Zgjedhor për tabulimin e rezultateve.”

¹⁵ KRIIK, Qëndrim Publik “[Funksionaliteti i auditit paszgjedhor, si një mekanizëm që konsolidon rolin dhe zhvillimin e përgjegjësive të KQZ-së drejt ligjzbatimit dhe ndëshkimit të politikës cënuese ndaj integritetit të vullnetit të votuesit](#)”, 14 dhjetor 2023 (faqe 4).

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Në gjykimin e KRIIK, ky është një numër tejet i lartë për një **shkelje që de-facto bën të pavlefshme votën e qytetarit dhe duhet të konsiderohet një shkelje e rëndë**, e ngjashme me atë të tjetërsimit të rezultatit të numërimit.

Kjo merr veçanërisht rëndësi nëse konsiderojmë bashkitë ku rezultati ishte shumë pranë dhe një numër i vogël votash të pavlefshme mund të sillnin ndryshim të kandidatit fitues për kryetar bashkie.

Raporti nuk përmban detaje nëse komisionerëve të angazhuar në këto qendra votimi u janë kërkuar shpjegime në lidhje me këtë shkelje dhe as nëse për këta do të propozohen sanksione.

Gjithashtu, dhe akoma më shqetësuese, nuk ka asnjë të dhënë në Raport nëse votat e pavlefshme si rrjedhojë e mos vulosjes janë të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë vendin apo ka disa qendra votimi që kanë një numër më të lartë të tyre apo sa është numri dhe si janë të shpërndara në ato bashki ku rezultati për kryetarin ishte shumë pranë. (çka do të përbente indicie për sjellje të qëllimshme nga ana e komisionerëve) dhe, nëse po, cilat janë ato.

Bërja e një vote të pavlefshme duke mos e vulosur atë në mënyrën e kërkuar nga ligji është përgjegjësi penale e komisionerit përkatës së qendrës së votimit dhe nuk mund të anashkalohet. Pra përgjegjësitë për këto raste do të duhet të jenë individuale.

Në raport me pavlefshmërinë e votave të konstatuara, në gjykimin e KRIIK, nevojitet që KQZ-ja të bëjë një shqyrtim të plotë të rrethanave të pavlefshmërisë, sidomos në rastet kur kjo votë është bërë e pavlefshme jo nga vetë votuesi, por nga mungesa e vulës në të, si pasojë e sjelljes aspak korrekte të komisionerëve.

KRIIK nxit KQZ-në për shqyrtim sa më të plotë e të drejtë të fakteve e rrethanave të konstatuara, duke përmbushur jo vetëm qëllimin që mbart në vetvete kryerja e këtij procesi, **por edhe nxjerrjen e mësimëve të nevojshme për përmirësimin e procesit në vijim**, sikurse është organizmi më i mirë i punës prej administratës, përgatitja më e mirë dhe këqyrja më e saktë dhe e hollësishme prej grupeve të numërimit, vlerësimi i votave të pavlefshme, rishikimi i moduleve të trajnimit për komisionerët, përfshirë kohëzgjatjen dhe periodicitetin e tyre, etj.

Në përfundim, **KRIIK gjykon se standardet e vendosura tashmë nga KQZ**, lidhur me sanksionimin e komisionerëve të gjendur në shkelje, **nuk duhet të zbehen në asnjë rast, pasi kjo sjell jo vetëm zhbërje të gjithë mekanizmit të kontrollit pas zgjedhor, por shënon edhe hapa pas në raport me nivelin e ligjzbatueshmërisë së vendosur tanimë nga KQZ në gjithë veprimtarinë e saj.**

Lidhur me gjithë sa më sipër, KRIIK sikurse në çdo rast, shpreh gatishmërinë për t'i sqaruar apo konsultuar ato në rast të vlerësimit të një nevoje të tilla nga Administrata e KQZ-së.

Duke ju falënderuar sërish për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

Për Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

**Premto Gogo
Kryetar**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania